
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”
ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË
MËSIMORE
PËR VITIN AKADEMIK 2013 -2014
DHE VEPRIMTARISË SHKENCORE DHE
FINANCIARE PËR VITIN 2014



Korçë, Janar 2014

Universiteti “Fan S. Noli”, si institucion publik, në zbatim të Nenit 15, pika 5 të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kryen analizën e ecurisë së procesit mësimor gjatë vitit akademik 2013-2014 dhe kërkimit shkencor për vitin 2014. Ai harton raportin e përvitshëm të vlerësimit, i cili paraqet në mënyrë të detajuar drejtimet në të cilat është zhvilluar veprimtaria e njësive dhe sektorëve përbërës të këtij institucioni, që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore të institucionit. Raporti synon të evidentojë drejtimet kryesore që përfshijnë veprimtarinë e organeve vendimmarrëse hapjen e programeve të reja dhe qëndrueshmërinë e programeve tashmë në funksion, prurjet e reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përshtatshmërinë e rregulloreve të programeve të studimit me kërkesat sa vjen e në rritje të tregut të punës në rajonin e Korçës, ngarkesat mësimore dhe burimet e literatures, si dhe drejtimet kryesore të aktivitetit kërkimor dhe shkencor të stafit akademik të universitetit.

Kjo analizë u përgatit falë kontributit të secilës prej njësive përbërëse të Universitetit, informacioneve të përditësuara të vëna në dispozicion nga sekretaritet mësimore, personeli ndihmës-mësimor dhe sektorët e administratës së Universitetit. Ajo përmban të dhëna të paraqitura në analizat përkatëse të Fakulteteve dhe është hartuar në bazë të kriterëve të pasqyruar në:

- Ligjin Nr.9741, datë 21.5.2007 “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, (i ndryshuar);
- Rregulloren e Studimeve të Universitetit “Fan S. Noli”;
- STATUTIN e Universitetit “Fan S. Noli”;
- Draft-Raporti i Monitorimit të Universitetit “F.S. Noli” hartuar nga grupi i ngritur nga MAS për Kontrollin e Zbatimit të Ligjshmërisë.
- Programin Afatgjatë për Zhvillimin e Universitetit “Fan S. Noli” mbi bazën e Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Lartë dhe Kushteve të Rajonit të Korçës:
- Raportet e analizave të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në departamente;
- Raportet e analizave të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në Fakultete;
- Raportet e Vlerësimit të Brendshëm të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- Standardet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë (APAAL, Tiranë, 2012).

Kjo analizë synon jo vetëm të evidentojë arritjet e deritanishme në drejtimet e sipërpërmendura, por edhe të nxjerrë në pah dinamikën e Universitetit “Fan S. Noli” në lidhje me përmbushjen e kritereve të Deklaratës së Bolonjës dhe të Standardeve të Sigurimit të Cilësisë. Në këtë këndvështrim ajo shërben njëkohësisht edhe si një raport vetvlerësimi për treguesit e matshëm të cilësisë në këtë Universitet dhe masat që duhen marrë në vijim për përmirësimet e nevojshme në këtë kuadër. Raporti përfshin gjithashtu arritje dhe problematika të evidentuara nga Raporti i hartuar nga Grupi i Kontrollit për Zbatimin e Ligjshmërisë, i ngritur me Urdhër Nr. 242, dt. 06.06.2014. Ky grup vizitoi Universitetin në periudhën 16-20 qershor 2014. Gjetjet e tij, të cilat janë pasqyruar në kapitujt në vijim, përbëjnë një element të rëndësishëm për vlerësimin e aktivitetit të deritanishëm si dhe planifikimit të mëtejshëm të aktiviteteve të njësive dhe sektorëve si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të stafit akademik për rolin që luan në procesin e sigurimit të cilësisë.

PËRMBAJTJA

1. ANALIZA E FUNKSIONIMIT TË ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UNIVERSITET

1.1 MBI ZBATIMIN E VENDIMEVE TË SENATIT PËR
VEPRIMTARINË MËSIMORE TË VITIT AKADEMIK 2013-2014

1.2 SEKTORËT DHE ADMINISTRATA E REKTORATIT

2. ANALIZA E VEPRIMTARISË MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014

2.1 QËNDRUESHMËRIA E VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË
PROGRAMEVE TË STUDIMIT SIPAS STANDARDEVE TË
CILËSISË

2.2 PRURJET E REJA DHE KËSHILLIMI I KARRIERËS

2.3 CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE PASQYRIMI I SAJ NË
REZULTATET PËRFUNDIMTARE

2.2 DREJTIME TË PUNËS PËR RITJEN E STANDARDEVE
AKADEMIKE

3. ANALIZA E VEPRIMTARISË SHKENCORE PËR VITIN AKADEMIK 2014

3.1 AKTIVITETE SHKENCORE TË ORGANIZUARA NGA
UNIVERSITETI

3.2 VEPRIMTARIA SHKENCORE BOTUESE

3.3 KUALIFIKIMI SHKENCOR

3.4 PJESËMARRJA NË PROJEKTE NË KUADËR TË ZGJERIMIT TË
INFRASTRUKTURËS SË KËRKIM-ZHVILLIMIT

3.1 DREJTIME TË PUNËS PËR RITJEN E AKTIVITETIT KËRKIMOR-
SHKENCOR

1. ANALIZA E FUNKSIONIMIT TË ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMARRËSE NË UNIVERSITET

1.1 MBI ZBATIMIN E VENDIMEVE TË SENATIT PËR VEPRIMTARINË MËSIMORE TË VITIT AKADEMIK 2013-2014

Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përcakton politikat e zhvillimit të Universitetit duke programuar, bashkërenduar, drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjatë vitit akademik 2013-2014 Senati Akademik ka vlerësuar efikasitetin e veprimtarive të mësipërme duke nxitur në mënyrë të vazhdueshme sigurimin e brendshëm të cilësisë në Universitet. Ai ka bashkërenduar funksionin e sektorëve dhe njësive përbërëse të Universitetit dhe ka ditur t'i japë frymë debatit konstruktiv në të mirë të mbarëvajtjes dhe komunikimit të brendshëm në Universitet.

Në mënyrë të përmbledhur, në mbledhjet e organizuara gjatë vitit akademik 2013 -2014, Senati mori vendimet e mëposhtme:

- *Miratimi i planeve mësimore dhe ndryshimeve në rregulloret e programeve të studimit, miratimin e listave të pedagogëve të ftuar dhe punësimin e pedagogëve me kontratë në fillim të vitit akademik;*
- *Miratimi i ngritjes së Komisionit të KA-së dhe KQZI-së, bazuar në Urdhrin Nr. 482, dt. 21.11.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL-të publike”;*
- *Miratimin e Analizës së Veprimtarisë Mësimore (2012- 2013), shkencore dhe financiare (2014) si dhe planifikimin e aktiviteteve të mësipërme për vitin akademik në vijim;*
- *Miratimin e Rregullores së programit të Dixhitalizimit të Sistemit Universitar ESSE3; si dhe të Manualit të Veprimtarisë së Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin “Fan S. Noli”;*
- *Miratimi i projekteve të paraqitura nga Fakultetet për rritjen e tyre akademike, si:*
 - a. *Botime i kumtesave të Konferencës së parë Ndërkombëtare të Sociolinguistikës, të Akteve të Akademisë Jubilarë për kongresin e drejtshkrimit dhe Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Lidhjet kulturore dhe historike shqiptaro-rumune” organizuar nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;*
 - b. *Identifikimi i faktorëve profesionalë të tregut për ekonomistët e rinj dhe përmirësimi i kurrikulave të orientuara drejt tregut si dhe Kontributi Shkencor i Fakultetit Ekonomik dhe rritja e*

aksesit të “produktit final” në tregun e punës, paraqitur nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë;

c. Botimi i përmbledhjes së Studimeve të Simpoziumit “*Didaktika e Shkencave*” si dhe organizimi i Konferencave shkencore kushtuar “*100-vjetorit të lindjes së Shkrimtarit S.Spasse*”, “*Kontributit në shkencat shëndetësore të Prof.Dr. Gj. Vreto*”, “*Zhvillimi Rajonal; Arritje dhe problem të Studimeve Doktorale*”, si dhe të Sesionit Shkencor “*Mendimi shoqëror dhe filozofik shqiptar*”, paraqitur nga fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane.

- *Miratimin e propozimeve për kuotat dhe tarifatat e shkollimit në programet e studimit për vitin akademik 2014-2015;*
- *Miratimi i projektbuxhetit për vitin 2015;*
- *Miratimin e ndryshimeve në strukturën e Universitetit me qëllim përshtatjen e saj me nevojat në rritje të institucionit;*
- *Miratimin për botim të dy serive të Buletinit të Universitetit; etj.*

Këto dhe të tjera vendime të marra në mbledhjet e vazhdueshme të Senatit dëshmojnë efektivitetin e vendimmarrjes në këtë organ, i cili shpresojmë se do të dëshmojë edhe në vazhdim të njëjtën përpjekje për bashkëpunim dhe mirëkuptim mes anëtarëve të tij përfaqësues të njësive dhe strukturave përbërëse të të gjithë Universitetit. ***Një nevojë sa vjen e në rritje është pjesëmarrja aktive e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik dhe lidhja e tij me e shpeshtë me Këshillin Studentor;*** gjë që do të nxitë, jo vetëm informimin më të gjerë të studentëve për aspekte të caktuara të vendimmarrjes që kanë lidhje të drejtpërdrejta me ta, por do të sjellë në diskutimet e këtij Organi problematikat e tyre që kanë nevojë për zgjidhje konkrete.

Gjatë vizitave në Fakultete dhe në Rektorat, Grupi i Kontrollit për Zbatimin e Ligjshmërisë, verifikoi dokumentacionin e vënë në dispozicion të tyre në lidhje me funksionimin e organeve kolegjiale, përfshi Këshillat e Fakulteve, Senatin Akademik, Këshillin e Profesorëve, Këshillin e Administrimit dhe Këshilli i Etikës. Grupi vlerësoi se ata kanë funksionuar në përputhje me Statutin, Rregulloren e Studimeve të Universitetit dhe Rregulloret përkatëse që përcaktojnë mirëfunksionimin e secilit prej këtyre organeve kolegjiale.

1.2. SEKTORËT DHE ADMINISTRATA E REKTORATIT

Spektori i Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional

Gjatë vitit akademik 2013-2014 aktiviteti i këtij sektori u përqëndrua ***në organizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe në rritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënësve.*** Përveç organizimit të punës së grupeve që hartuan Raportet e Vetvlerësimit për çdo fakultet, kjo njësi u

angazhua në diskutimin e këtyre raporteve në Këshillat e Fakulteteve dhe në krijimin e mundësisë që i gjithë stafi akademik të informohej për gjetjet e këtyre raporteve. Raportet e Vlerësimit të Brendshëm u hartuan sipas formatit të bërë publik nga APAAL-i në Shqipëri me qëllim lehtësimin e përpunimit të të dhënave që do të kërkohen në kuadër të procesit të akreditimit që do të ndërmerret nga MAS për të gjitha IAL-të shqiptare, në vijim të këtij viti akademik.

Raportet e vlerësimit të brendshëm në rang Fakulteti u kërkuan të hartohen dhe të dorëzohen para realizimit të Analizës së përgjithshme në rang Universiteti, në mënyrë që një pjesë e arritjeve dhe problematikave që u paraqitën në to të mund të parashtrihen si çështje diskutimi në këtë raport.

Gjatë viti 2013-2014, në bashkëpunim me Rektoratin, ky sektor realizoi dy anketime, të cilët synuan marrjen e një mendimi më të gjerë në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me cilësinë e mësimdhënies dhe komunikimin në auditor, dhe në lidhje me hartimin e një Analize SWOT (*Pika të forta/ të dobta; Mundësi/ Rreziqe*) më të plotë dhe më të qëndrueshme. A) I pari u realizua me studentët e ciklit të parë dhe të dytë në të gjithë Fakultetet gjatë muajit prill 2014. Në të anketuan **1047 studentë** në lidhje me çështje që trajtonin cilësinë e mësimdhënies në auditor dhe lidhjen e saj me rezultatet e pritshme nëprovime. ***Analiza e pyetësorëve nxori në pah problematika praktike të cilat kanë nevojë të diskutohen në mënyrë konkrete në Këshillat e Fakulteteve me qëllim reduktimin e mospërputhjeve dhe rritjen e përfshirjes së studentëve në procesin e të nxënit.***

B) Pyetësori i dytë u realizua vetëm me stafin akademik. Ai kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave konkrete nga secili department për hartimin e një Analize SWOT në rang Fakulteti. Të dhënat e këtij pyetësori u përdorën nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për hartimin e raportit të Vlerësimit. *Kjo veprimtari nxori në pah faktin që një pjesë e stafit akademik e shohin veten të shkëputur nga veprimtaritë që i përkasin aktiviteti jashtë auditorit dhe mësimdhënies. Ata e konsiderojnë cilësinë në programet e studimit nje element që i përket vetëm përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si dhe autoriteteve drejtuese.*

Në fakt çdo element i sigurimit të cilësisë ka të bëjë me një rreth që bashkon në vetvete problematikat që dalin nga veprimtaria e përditshme mësimore (staf akademik dhe studentë), kalon në diskutim në Departamente dhe Këshilla Fakultetesh, paraqitet si një problematikë që kërkon zgjidhje të mundshme në Senatin Akademik

dhe e gjen përsëri zbatimin te vetë stafi akademik. Prandaj është e domosdoshme që i gjithë stafi akademik të ndërgjegjësohet për sa më sipër dhe ta përfshijë veten më tepër në veprimtari në të cilat kërkohet mendimi i tyre për sigurimin e cilësisë.

Për vitin akademik 2014-2015, Sektori i Kurrikulave dhe Vlerësimit Insitucional do të vazhdojë të punojë me përmirësimin e kurrikulave të programeve të studimit, sidomos me ndryshimet e pritshme në këtë drejtim pas miratimit të Ligjit për Arsimin e Lartë. Ai do të monitorojë në vazhdimësi procesin mësimor dhe plotësimin e dokumentacionit që ka lidhje me rritjen e cilësisë në materialet që u vihen studentëve në dispozicion gjatë mësimdhënies nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm të Dosjes Akademike të pedagogut. Gjithashtu, në vijim të komunikimit shumë të mirë që ka pasur me Dekanët e Fakulteteve, ky sektor kërkon përsëri mirëkuptimin dhe mbështetjen e tyre në organizimin e vazhdueshëm të anketimeve me studentët dhe pse jo edhe ndërmarrjen e nismave të tilla nga vetë Këshillat e Fakulteteve dhe Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm. Këto veprimtari do të kenë vazhdimisht mbështetjen e Rektoratit dhe do ta ndihomjnë në mënyrë më konkrete rritjen e cilësisë në secilin prej programeve të studimit.

Ky sektor duhet të vazhdojë komunikimin e nisur tashmë me Këshillin Studentor dhe Qendrën e Karrierës; komunikim që do ta ndihmonte pozitivisht këtë proces në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket Rregullores së Studimeve, Rregullores së Etikës së Universitetit, si dhe Rregulloreve të Programeve të Studimit. ***Përvoja e nisur nga kjo Zyrë me organizimin e disa takimeve me studentët e të katër Fakulteteve duhet të merret përsipër dhe të organizohet me takime më të vazhdueshme nga vetë Këshillat e Fakulteteve, Përgjegjësat e Departamenteve në bashkëpunim me Grupet e Vlerësimit të Brendshëm dhe me përfaqësuesit e studentëve në Këshillat e Fakulteteve dhe në Këshillin Studentor.***

Sektori i Studimeve dhe Karrierës

Qendra e Karrierës (QK) është pajisur tashmë me gjithë infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për të zhvilluar një veprimtari të pasur dhe të larmishme gjithëvjetore. Gjatë vitit akademik 2013-2014 aty u zhvilluan një sërë aktivititesh me studentët dhe për studentët që në fillim patën karakter promovues të rolit të kësaj Qendre si dhe synuan krijimin e një grupi studentësh që do të vijonin punën si studentë vullnetarë pranë saj. Më vonë këto aktivitete u zhvilluan në bazë të një plani pune, i cili u pasurua në vazhdimësi me organizimin e takimeve mes studentëve dhe institucioneve apo

organizatave të ndryshme që kanë si objekt pune rritjen në karrierë të studentëve të diplomuar dhe hedhjen e tyre të sigurt në tregun e punës.

Në bashkëpunim me përfaqësues nga Rektorati dhe nga Fakulteti i Ekonomisë, QK-ës zhvilloi një takim me përfaqësues të bizneseve në rajonin e Korçës për të shqyrtuar mundësitë e kontributit të dyanshëm në tëmirë të formimit dhe pastaj punësimit të studentëve të këtij Fakulteti. *Nga takimi u vu re se biznesi ndjen një boshllëk në gjetjen e studentëve cilësorë që mund të punësohen pranë tij, ndërkohë që në Universitet nuk mungojnë elementë të tillë. Aty u sugjerua përfshirja e njohurive më praktike në mësidhënie në lidhje me natyrën e drejtpërdrejtë të formimit në programet e studimit Finance-Kontabilitet si dhe gadishmëria për të mirëpritur student praktikantë të cilët, pas trajnimit disa javor, do të mund të punësoheshin në to pas diplomimit. Kjo është një përvojë që duhet të zhdërrohet në një traditë pune, jo vetëm si iniciativë e QK-ës, por si një aktivitet i këtij fakulteti që e mban kurrikulën e vet vazhdimisht të lidhur me kërkesat e tregut të punës.*

Këshillimet individuale me studentët për programe bursash si dhe leksionet me grupe të vogla studentësh mbi mënyrën si të shkruajnë një CV, si të paraqiten në intervistën e punës, si të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm para një interviste, etj u zhvilluan gjatë gjithë vitit akademik dhe u intensifikuan gjatë Javës së Karrierës që parapriu Panairin e Punës në Maj 2014 (në organizimin e të cilit Universiteti ishte një partner). Studentët kanë pasur interes për këto trajnime dhe përvoja e shkëmbyer me përfaqësuesit nga USAID, AIDA, Zyra e Punës, Bashkia e Qytetit, Qendra e Formimit Profesional, kanë krijuar tashmë një shteg të sigurt mbi të cilin të krijohet një kurrikul trajnimesh të shtrira në module që pajisin studentët me njohuritë bazë të rritjes në karrierë.

Në këtë kuadër të gjitha fakultetet duhet të krijojnë mundësinë e përfshirjes në kurrikulat e studimit një lëndë që të ketë lidhje me Këshillimin e Karrierës si një element mbështetës që do të plotësojë formimin e studentit edhe pas diplomimit.

QK ka tashmë një Web-Portal i cili është në fazën e eksperimentimit dhe synon të krijojë një rrjet të qëndrueshëm studentësh dhe alumni-sh, bizneseve që ofrojnë vende të lira dhe njoftimesh të vazhdueshme për sa më sipër.

Grupet e Vlerësimit të Brendshëm tashmë kanë krijuar një grup fillestar studentësh që së bashku me përfaqësuesit e Këshillit Studentor do të shërbejnë si pikat e para të kontaktit dhe si elementët bazë të rrjetit që nevojitet për të rritur ndërgjegjësimin e studentëve në lidhje me rolin e tyre në veprimtaritë universitare jashtë auditorëve. Vlerësojmë mirëkuptimin e dekanateve për veprimtaritë e deritanishme të kësaj Qendre dhe shpresojmë se që sot e tutje

ata do ta angazhojnë dhe do t'i besojnë këtij sektori veprimtari që lidhen me formimin studentor jashtëkurrikular në secilën prej specifikave që ofron natyra e programeve të veçanta. Ka ardhur koha që veprimtaria e QK të matet me numrin e studentëve që punësohen pas diplomimit dhe me numrin e atyre që aplikojnë, dhe fatmirësisht, fitojnë bursa studimi apo mundësi mobiliteti gjatë studimeve të tyre.

Sektori i Informacionit dhe Komunikimit dhe Statistikës

Krahas veprimtarive të përditshme që mbulojnë zgjerimin dhe përdorimin efikas të teknologjisë së informacionit, gjatë këtij viti ky sektor punoi me proceset e vendosjes dhe përditësimit të të dhënave në bazën e të dhënave të studenteve dhe përpunimit të tyre në një sistem online dixhital në kohë reale. Procesi synon të ndikojë në mënyrë thelbësore në mirëmenaxhimin e proceseve të sekretarive mësimore, të burimeve njerëzore, të drejtorisë së financës dhe të shërbimeve studentore, sepse rrit shpejtësinë, transparencën dhe efektivitetin e shërbimit. Gjithashtu, sistemi krijon mundësinë për të gjeneruar në kohë reale dhe saktësisht të gjitha informacionet statistikore që kërkojnë institucionet shtetëore, si MASH, AKP, INSTAT, APAL etj.

- Deri në këto momente është plotësuar pjesa e parë e modulit e cila kishte të bënte me trajnimin e sekretarive mësimore dhe sekretarive të studentëve si dhe me hedhjen në sistem të të gjitha programeve të studimit për vitin akademik 2013-2014 në të gjitha ciklet e studimit.
- Gjithashtu u mundësua krijimi i një regjistri themeltar online për vitet e para në të gjitha ciklet.
- Në plotësim të sugjerimeve të bëra nga Grupi i Monitorimit për Zbatimin e Ligjshmërisë në lidhje me ruajtjen e të dhënave të sekretarive mësimore, ky sektor monitoroi punën e sekretarive për hedhjen e të dhënave në një regjistër të veçantë, sipas formatit të dërguar nga MAS-it, për kopjet e printuara të të cilëve jemi ende në pritje.
- Ndërkohë sekretaritë mësimore janë duke hedhur të dhënat që kanë të bëjnë me rezultatet e studentëve deri në vitin akademik 2013-2014, nga tabelat e përdorura si Pasqyrat e Lëndës në regjistra të unifikuar për të gjitha fakultetet. Vlerësojmë këtu gadishmërinë dhe mirakuptimin e sekretareve si dhe angazhimin e tyre në këtë proces që kërkon vëmendjen e tyre përtej veprimtarive të përditshme.
- Përsa i përket infrastrukturës dhe sigurisë në rrjet, sistemi i universitetit menaxhohet nga një sistem antivirusi, i cili ka rritur në maksimum mundësinë e mbrojtjes nga aplikacione virusesh apo ndërhyrje të paautorizuara në rrjetin universitar.

-
- Faqja e Internetit e Universitetit po funksionon më mirë dhe është përditësuar vazhdimisht, duke pasqyruar një pjesë të konsiderueshme të informacionit që qarkullon në këtë institucion, në të mirë të gjithpërfshirjes dhe informimit publik rreth veprimtarive dhe aktiviteteve në Universitetin “Fan S. Noli”. Faqja funksionon edhe në gjuhën angleze dhe, me ndihmen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, u bë i mundur publikimi në të në gjuhën frënge i një pjese të madhe të informacionit.

Aktualisht, sektori në fjalë është duke u punuar në lidhje me:

- 1) Publikimin online të lëndëve dhe moduleve për çdo program studimi dhe për secilin pedagog;
- 2) Përditësimin në sistem të pagesave të studentëve (në mënyrë që studentët që kanë kryer pagesat mos të dalin në procesverbal me detyrime);
- 3) Krijimin e një regjistri themeltar elektronik të studenteve sipas Udhëzimeve të fundit nga MAS.
- 5) Përmirësimin e menaxhimit të sistemit antivirus nëpërmjet lidhjes së dy konsolave të menaxhimit të sistemeve antivirus (midis konsolës qëndrore dhe konsolës së sistemit antivirus në FSHNH).
- 6) Krijimin në websitin e universitetit të lidhjes së emërtimit të programeve të studimit me publikimin online të lëndëve dhe moduleve në sistemin dixhital, duke unifikuar kështu gjithë informacionin e nevojshëm për të gjitha programet e studimit të universitetit.

Sektori i projekteve dhe kërkimit shkencor

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve në Universitet, gjatë vitit 2013 - 2014 Zyra e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor ka realizuar një sërë aktivitete që kanë pasur kryesisht në fokus:

- Botimin e dy serive të Buletinit Shkencor
- Trajnime për pedagogët në lidhje me mundësitë e aplikimit në projekte të ndryshme dhe mbështetjen teknike që kjo zyrë ofron për të interesuarit. Rezultat i kësaj pune ishte rritja e numrit të aplikimeve për projektet e Fondacionit Soros për doktorantët e rinj.
- Përcjellja e informacionit në lidhje me aktivitete shkencore (konferenca e botime) kombëtare e ndërkombëtare. Ky informacion është shpërndarë me emaile tek të gjithë pedagogët sipas fushave përkatëse.
- Mbështetja e zhvillimit të kurseve të gjuhës angleze falas për pedagogët e universitetit nga vullnetarë të Korpusit të Paqes.
- Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për punën kërkimore-shkencore të universitetit. Pjesë e saj janë bërë një sërë botimesh të librave, artikujve në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe lista e plotë e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore.

Zyra e projekteve dhe e kërkimit shkencor është tashmë pjesë e rrjetit kërkimor- shkencor CONSUS. Ky rrjet synon ndërveprimin shkencë-shoqëri për një zhvillimin të qëndrueshëm dhe mundëson shkëmbimin e përvojës mes aktorëve me përvojë dhe atyre që aplikojnë për ide inovatore. Për më tepër, ai synon edhe zhvillimin e materialeve inovatore për mësimdhënien në IAL me anë të nxitjes së stafit akademik për aplikimin e metodave dhe materiale që sjellin ndryshim në mësimdhënie.

Përveç menaxhimit të disa problemeve që do të përshkruhen në vijim në analizën e veprimtarisë kërkimore-shkencore, në veprimtarinë e tij për vitin 2015, ky sektor duhet të jetë në krye të aktiviteteve që Universiteti do të ofrojë për rritjen e kapaciteteve të stafit akademik, si psh. trajnime në përdorimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, hartimin dhe shkrimin e projekteve, kurse të gjuhës së huaj, përpunimi statistikor i të dhënave, etj.

2. ANALIZA E VEPRIMTARISË MËSIMORE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014

a. QËNDRUESHMËRIA E VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT SIPAS STANDARDEVE TË CILËSISË

Gjatë vitit akademik 2013-2014, Universiteti “Fan S. Noli” ofroi programe studimi në të tre ciklet e studimit, përkatësisht:

- 25 programe studimi Bachelor me kohë të plotë;
- 15 programe studimi Bachelor me kohë të pjesshme;
- 14 programe studimi Master Profesional me kohë të plotë
- 2 programe Master Profesional me kohë të pjesshme;
- 5 programe studimi Master Shkencor;
- 1 program studimi Doktoraturë.

(Për detaje referoju tabelës së programeve në SHTOJCËN 1 të këtij raporti)

Nga Analizat e Veprimtarisë Mësimore të realizuara në Fakultete rezulton se tipari i përgjithshëm i aktivitetit të tyre në lidhje me qëndrueshmërinë e programeve të studimit ka qenë *ristrukturimi i kurrikulave dhe programeve mësimore duke u përqëndruar kryesisht te rishikimi i lëndëve apo moduleve që i afrojnë kurrikulat me zhvillimet e tregut të punës, me mundësitë e reja që ofron shkëmbimi i përvojës me universitete simotra dhe me informacione që përditësohen vazhdimisht nga veprimtaria e kërkimit shkencor që realizojnë pedagogët në fushat përkatëse.*

Përgjegjësat e Departamenteve dhe organet vendimmarrëse në Fakultete u angazhuan në *ristrukturimin e Rregulloreve të pjesës më të madhe të Programeve të Studimit* duke i plotësuar ato me informacionin bazë që lidhet me objektivat e programit të studimit, mundësitë që ai ofron për punësim, formën e studimit, mënyrën e vlerësimit dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion për zhvillimin normal të procesit mësimor në të. Rregulloreve iu bashkëngjitën syllabuset e plota të lëndëve apo moduleve përkatëse në mënyrë që të dhënat e tabelave të planeve mësimore të gjejnë pasqyrim të plotë në organizimin e elementëve përbërës të secilit syllabus.

Përsa i përket planeve mësimore u tregua kujdes që të *përmirësohej ndjeshëm raporti mes orëve në auditor, orëve jashtë auditorit (sipas specifikave të moduleve) dhe numrit të krediteve përkatëse.* Ky ishte një element të cilit iu kushtua vëmendje e posaçme edhe në ndryshimet që u miratuan në Rregulloret e programeve të studimit për vitin akademik 2014-2015 dhe që patjetër do të jetë objekt ndryshimesh edhe për kurrikulat e vitit të ardhshëm me ndryshimet që priten të shoqërojnë Ligjin e ri të AL-të.

Gjithësesi, përvoja e krijuar në këtë drejtim do ta lehtësojë përshtatshmërinë e kurrikulave të reja me çdo kërkesë që do të paraqitet në të ardhmen. *Një version i shkurtuar i Rregullores së Programeve të Studimit që ofrohen për këtë vit akademik është duke u hedhur në faqen zyrtare të internetit, i shoqëruar edhe me versionin përkatës në anglisht.*

Të dhënat e mësipërme pasqyrojnë rritjen sa vjen e më tepër të kapaciteteve të Universitetit ***si një institucion i arsimit të lartë që përmbush në mënyrë të vazhdueshme nevojat për kualifikim universitar në të tre ciklet dhe në të dy sistemet e studimit të zonës juglindore të Shqipërisë.***

Këto të dhëna përbëjnë njëkohësisht një sfidë që stafi akademik dhe autoritetet drejtuese të universitetit duhet ta përballin në vazhdim në lidhje me përshtatshmërinë e programeve të studimit sipas ndryshimeve që sugjerojnë zhvillimet ekonomiko-shoqërore të rajonit, sasia dhe cilësia e prurjeve studentore në vitin e parë dhe përshtatja e cilësisë së mësimdhënies në varësi të nevojave që ata kanë, sidomos për programet e studimit që paraqesin një numër të vogël prurjesh nga viti në vit apo për programet të cilët nuk e tërheqin më vëmendjen e aplikantëve dhe që rrezikojnë mbylljen.

o ***Konsolidimi i programeve të studimit në kuadër të rritjes institucionale***

Në lidhje me sa u paraqit më lart, rreth masave që janë marrë apo që duhet të ndërmerren për të rritur qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e programeve të studimit, po paraqesim në vijim një sërë ndryshimesh që u ndërmorën gjatë viti akademik 2013-2014 nga Fakultet si dhe një analizë të rezultateve të pritshme nga këto ndryshime të shoqëruara me zgjidhjet e mundshme të propozuara nga Këshillat përkatëse të Fakulteteve.

Rregulloret e programeve të studimit do të jeni objekt i ndryshimeve të vazhdueshme për të pasqyruar nevojën për përshtatjet me ndryshimet ligjore, shoqërore dhe ekonomike të vendit dhe zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të promovojnë etikën profesionale të studentëve të diplomuar. Megjithatë ky nuk duhet parë si një element kryesor i vëmendjes së zhvillimit të kurrikulave. Pjesa më e madhe e programeve të studimit tashmë shfaqet e konsoliduar dhe diskutimet e njëjësive kryesore të Fakulteteve duhet të përqëndrohen në rrugët për përmirësimin dhe rimëkëmbjen e programeve që tashmë kanë shfaqur elementë problematikë në frekuentimin e studentëve. Siç u tha më sipër, ristrukturimi i kurrikulave të tyre është një ndër mënyrat që do të ndihmojë

rihapjen e tyre, megjithatë është shumë e nevojshme që departamentet të mblidhen së bashku për të gjetur mjete të tjera më specifike që do të tërheqin maturantët e rinj në programet e pezulluara, apo në programet e ciklit të dytë që nuk janë frekuentuar thuajse fare.

2.2 PRURJET E REJA DHE KËSHILLIMI I KARRIERËS

Gjatë vitit akademik 2013 - 2014, në vitin e parë u regjistruan **1143 studentë** nga *1341 kuota* të shpallura fituese në programet Bachelor. Rënie të ndjeshme patën programet *Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Frënge, Mami, Filozofi-Sociologji, Teknologji Informacioni, Administrim Biznesi në Marketing, Administrim Biznesi në Turizëm, Mjekësi e Bimëve Hortikulturë dhe Teknologji e Prodhimit Bimor.*

Gjatë vitit akademik 2012 -2013 në Universitetin e Korçës ndoqën studimet **6970 studentë** dhe u diplomuan **1258 studentë** në të dy ciklet e sistemeve me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Në vitin akademik 2013-2014 Universiteti pati **6496 studentë aktivë** dhe u diplomuan **1667 studentë**. (Referoju SHTOJCËS II) *Viti aktual paraqet një rënie të mëtejshme të numrit të studentëve, për shkak të reduktimit të numrit të kuotave për studentët e regjistruar në vitin e parë, mbylljen e programeve me kohë të pjesshme dhe mbylljen e Filialit të Pogradecit. Me gjasa kjo prirje do të vazhdojë edhe në vitet në vijim nëse nuk bëhet diçka në lidhje me tërheqjen e vëmendjes së maturatëve.*

Departamentet duhet të punojnë më tepër në krijimin e një plani aktiviteteve të vazhdueshme që lidhen me aktivizimin e studentëve në veprimtari shkencore dhe në promovimin e vlerave të këtyre programeve, ashtu siç u veprua gjatë aktiviteteve të paraqitura në vijim të organizuara nga Departamenti i Marketing-Turizmit dhe nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Këshillin Studentor.

- Panairi i Turizmit (dhjetor 2013) me pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Turizëm”;
- Panairi i Pasticërisë (qershor 2014) me pjesëmarrjen e studentëve të programit të studimit “Marketing”.
- Më 14.7. 2014 u mbajt Konferenca studentore me temë “*Ndihmesat e studentëve në kërkimin shkencor*”. Departamentet e Gjuhës dhe Letërsisë, i Gjuhëve të Huaja dhe Departamenti i Edukimit.
- Në qershor 2014 me studentët e programit “Master Profesional në Gjuhë-Letërsi”, në kuadër të lëndës minore “Teatër” u bë paraqitja

e veprës “Diva shqiptare” të autorit Miho Gjini, për nder të aktores Margarita Xhepa.

- Në veprimtarinë për Adem Demaçin studentët e gjuhë-letërsisë recituan pjesë nga vepra e këtij autori.
- Gjatë vitit të kaluar akademik me pjesëmarrjen e studentëve të talentuar u zhvilluan disa veprimtari nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja (për përkthimet më të mira), i Gjuhës dhe Letërsisë (me krijimet më të mira të studentëve), i Histori-Gjeografisë (me kumtesa për 70-vjetorin e Çlirimit) etj.
- Këshilli Studentor i Fakultetit të Edukimit, hapi ekspozitën me krijimet e studentëve piktorë: Dajana Shkëmbi, Taulant Zaçlli, Thanas Dushku.

Çdo department në universitet duhet të mendojë për aktivitete studentore sipas specifikave dhe hapësirave që ofron secili program studimi në të cilat maturantët të përfshihen si pjesëmarrës apo si të ftuar dhe të krijojnë në këtë mënyrë lidhje paraprake që shkojnë përtej vizitave në shkollat e mesme të rajonit gjatë ditëve të fushatës së promovimit.

Përvojat e filluara në vitin 2013-2014 në rang universiteti për promovimin institucional me anë të Guidës së Universitetit, botimit dhe shpërndarjes së fletëpalosjeve, përditësimit të vazhdueshëm të faqes së internetit, krijimit të rrjetit të studentëve të qendrës së karrierës, përgatitjes së spoteve televizive dhe pjesëmarrjes së pedagogëve dhe studentëve në emisione televizive, duhen parë në vijim si elementë përbërës së aktivitetit që secili pedagog harton në mbështetje të insitucionit në të mirë të rritjes së vlerave të programit të studimit ku ai jep mësim.

Stafi akademik dhe ngarkesa mësimore

Për vitin akademik 2013-2014 Përgjegjësat e Departamenteve dhe Këshillat e Fakulteteve u kujdesën që të zbatonin masat e nisura nga viti paraardhës në lidhje me reduktimin e ngarkesave të panevojshme. Pedagogët e mbrendshëm u lejuan të merrnin deri në 70% të ngarkesës së normuar mësimore për të reduktuar numrin e pedagogëve të ftuar dhe për të lehtësuar zhvillimin normal të procesit mësimor.

Gjithësesi ngarkesa e tepërt mësimore e pedagogut është një element që ndikon në cilësinë e tij të mësimdhënies dhe redukton orët e aktivitetit të tij kërkimor-shkencor. Në këtë kuadër për vitin akademik 2014-2015 u kërkua nga pedagogët e brendshëm që brenda mundësive të mos e tejkalojnë 30% të ngarkesës të ngarkesës mësimore të normuar. Kjo do t'u japë atyre mundësi të rritin vëmendjen e tyre në fushat e interesit për

kërkimin shkencor dhe të kenë hapësirën e nevojshme për të kontribuar më tepër në veprimtaritë mbështetëse për institucionin. *Gjatë vitit të ardhshëm akademik, pedagogëve do t'u kërkohet pjesëmarrje konkrete në grupe të caktuara punë që kryejnë dhe menaxhojnë veprimtari jashtë kurrikulare në mbështetje të insitucionit si një element i domosdoshëm për plotësimin e marrëveshjes së kohës vjetore të punës në një IAL.*

2.3 CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE PASQYRIMI I SAJ NË REZULTATET PËRFUNDIMTARE

Problematika e radhës në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit në universitet është *shkalla e kalueshmërisë në çdo program studimi* si një çështje që pasqyron kombinimin e drejtë të tre elementëve:

1. cilësia e mësimdhënies, kualifikimi i stafit akademik dhe përshtatja e infrastrukturës mësimore;
2. nxitja e të nxëniet si një element i rëndësishëm i përfshirjes studentore brenda dhe jashtë auditorit
3. cilësia e studentëve në hyrje.

Tabela e mëposhtme pasqyron shkallën e kalueshmërisë për sistemin me kohë të plotë në rang universiteti sipas cikleve përkatëse të studimit:

Nr.	Fakulteti	Shkalla e kalueshmërisë
1.	Fakulteti i Shkencave	72%
2.	Fakulteti i Bujqësisë	88%
3.	Fakulteti i Ekonomisë	73%
4.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	80%

Tabela e mësipërme nuk është paraqitur për të bërë dallimin mes fakulteteve, sepse një përjasje e tillë do të ishte krejt e pavënd për shkak të specifikave të natyrës së punës dhe llojit të njohurive që ofron secili. Ajo është hartuar në bazë të të dhënave të raporteve të secilit prej Fakulteteve. Në këto të dhëna paraqitet në mënyrë të detajuar kalueshmëria në çdo program studimi sipas kurseve të studimit. Analiza e këtyre tabelave duhet t'i nxisë *Përgjegjësat e Departamenteve të nxjerrin në pah arsyet e luhatjes së kalueshmërisë nga kursi në kurs; të reflektojnë në lidhje me arsyet e ndryshimeve shumë të mëdha të kalueshmërisë nga lëndë në lëndë dhe raportit mes numrit të studentëve në hyrje për një program studimi dhe atyre*

që diplomohen në përfundim të ciklit të studimit. Kjo analizë do të jetë në të mirë të rritjes së standardit të mësimdhënies nga njëra anë, lidhjes së saj me nivelin e studentëve, si edhe përmirësimin të komunikimit student-pedagog dhe marrjes parasysh të interesave të studentëve.

Aktualisht procesi mësimor zhvillohet në ambiente të pajisura jo vetëm me materialet bazë të mësimdhënies por edhe me mjete bashkëkohore të teknologjisë së informacionit. Infrastruktura mësimdhënëse dhe facilitetet që ofron Universiteti janë dy element që u vlerësuan pozitivisht edhe nga raporti i grupit të Kontrollit për Zbatimin e Ligjshmërisë.

- Mënyrave klasike të leximit të leksioneve u ka ikur koha dhe pedagogët tentojnë sa vjen e më tepër bashkëbisedimin dhe përfshirjen aktive të studentëve në auditor. Këtë e ndihmon **përdorimi i teksteve të botuara** nga pedagogë të vetë universitetit apo studiues të tjerë shqiptarë dhe të huaj dhe **dispencave**, të cilat po zëvendësojnë sa vjen edhe më tepër leksionet e dhëna në mënyrë të shkëputur në auditor.

Krahas ristrukturimit të planeve, pasurimit të përmbajtjes së syllabuseve dhe përditësimit të materialeve që përfshihen në to me studimet e reja në të gjitha fushat, vëmendje e veçantë i kushtohet edhe metodave të mësimdhënies. **Studentët nxiten të punojnë dhe mësojnë në mënyrë të pavarur me anë të metodave të të nxënimit me në qendër nxënësin.**

Leksioni i përparuar përdoret si një metodë që nxit të menduarin kritik te studentët dhe siguron gjithpërfshirjen e tyre në auditor. Tashmë pjesa më e madhe e pedagogëve preferojnë metodën e *diskutimeve të hapura, diskutimin e rasteve specifike dhe analizën e shembujve konkretë*. Realizimi i orëve në auditor, pa i ndarë në leksione dhe seminare, i ka vënë pedagogët përpara përgjegjësisë për një ndërthurje më të natyrshme të dhënies së njohurive të reja me kontrollin e tyre në forma të ndryshme, si psh: duke shmangur pyetjet riprodhuese dhe duke hartuar *pyetje të nivelit të lartë*, të cilat japin mundësi për një përfshirje më të madhe të studentëve në diskutime; duke kërkuar *realizimin e testeve* brenda një kohe të shkurtër në auditor dhe shumë forma të tjera, çka bën që studentët të jenë të vëmendshëm dhe të marrin pjesë aktive në realizimin e procesit mësimor. ***Zbatimi në sistem i metodave të një mësimdhënieje ndërvepruese dhe të përqendruar te studenti, ndryshimi i natyrës së marrëdhënieve ndërmjet pedagogëve dhe studentëve në auditor, në mënyrë që ajo të jetë e bazuar në diskutime, në të menduarit dhe të zhvilluarit të ideve etj., mbeten për të gjithë detyra të vazhdueshme.***

Kjo do të thotë që duhen bërë më tepër përpjekje me pajisjen e studentëve me aftësi praktike. Zhvillimi i praktikave mësimore, apo detyrave të kursit që

kanë për bazë bizneset e Rajonit apo edhe më gjerë, (praktika këto të zbatuara nga pedagogët e Universitetit tonë) janë një shembull i mirë për *pajisjen e studentëve me shprehitë praktike të arsytimit*. Për këtë edhe programet e praktikave mësimore janë rishikuar gati çdo vit.

- **Përcaktimi i vlerave të duhura të vlerësimit të vazhduar në syllabuset përkatëse të lëndëve ka shmangur vlerësimet fiktive dhe ka ndërgjegjësuar studentët në lidhje me vlerën që ky vlerësim mbart në rezultatitn e tyre përfundimtar në provim.** Për vlerësimin e dijeve të marra nga studentët për vitin akademik 2013-2014, elementi kryesor ishte provimi. Teza e provimit u hartua me 70 pikë dhe minimumi për të marrë notë kaluese ishte 41 pikë. Këto metoda do të krijojnë një pamje më të plotë dhe më të qartë të cilësisë së studentëve dhe përgatitjes së tyre në provimet e mbartura.
- *Mjetet audio-vizive dhe ato laboratorike po përdoren në mënyrë efikase si në orët e praktikave edhe në ato të seminareve ku studentët nxiten të paraqesin arritjet e tyre në lëndë apo module me karakter praktik duke përdorur prezantimet në PowerPoint. Gjithësesi, nga anketimet me studentët vihet re se ka një mbipërdorim të projektorit si një mjet i përcjelljes së njohurive në auditor. Pedagogët nuk duhet të anashkalojnë funksionin kryesor të tabelës dhe shkumësit, të cilat në çdo rast mbeten mjetet bazë të ndërveprimit mësimdhënie –mësimnxënie në auditor.*

Një punë më e madhe duhet bërë në këtë drejtim për të rritur komunikimin online mes studentëve dhe pedagogëve duke vendosur në dispozicion të studentëve adresat e email-eve institucionale që ka çdo pedagog; kjo jo vetëm do të lehtësojë komunikimin, por do të zgjerojë edhe gamën e veprimtarive mësimore dhe kërkimore që studenti zhvillon jashtë auditorit si pjesë e punës së tij për marrjen e krediteve.

Këtë gjithpërfshirje studentore e ka ndihmuar edhe **hapja e faqes së internetit për Qendrën e Karrierës Studentore**, e cila do të publikojë të dhëna rreth veprimtarive që organizon universiteti në lidhje me studentët, por edhe të reja që ofron tregu i punës për të diplomuarit dhe një zë më vete për **sondazhe online që do të jenë pjesë e vazhdueshme e aktivitetit të Sektorit të Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional**.

- *Laboratorët pajisen rregullisht me materiale mësimore shtesë. Në funksion janë laboratorët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Laboratorët e Biologjisë dhe Kimisë në Fakultetin e Shkencave. **Megjithatë është e novojshme që baza materiale që ofrojnë disa laboratore të tjerë të shfrytëzohet në mënyrë më efektive për analiza studimore, shkencore dhe ato të prodhimit.** Duke qenë se teknologjia që ata ofrojnë është e re duhet*

bashkëpunuar me tepër me firmat që i kanë instaluar për trajnimin e pedagogëve që do të punojnë me këto pajisje laboratorike.

- *Bibliotekat e Fakulteteve* u pasuruan edhe më tepër me fonde librash dhe materialesh të botuar në gjuhën shqipe, angleze dhe frënge.

Biblioteka e Fakultetit	Fondi i Librave	Numri i të regjistruarve	
		Studentë	Staf akademik
Fakultetit i Bujqësisë	1991	50	20
Fakulteti i Ekonomisë	4670	200	30
Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane	2762	224	60
Qendra e Ekselencës FSH	1284		
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	14 500	406	87
Qendra e Ekselencës FEF	730		

Duke e parë bibliotekën si një laborator të gjallë për realizimin cilësor të programeve të studimit, do synohet që në vitin akademik 2014-2015 biblioteka të kthehet me të vërtetë në një qendër studimi dhe hulumtimi duke i angazhuar studentët në realizimin e detyrave të kursit, projekteve dhe aktiviteteve që kanë lidhje me materialet dhe informacionet e bibliotekave të fakulteteve. Rritja e fondit të librave në to, si rrjedhim i rritjes së vlerës së buxhetit të parashikuar për këtë zë.

2.4 QENDRAT E EKSELENCËS NË UNIVERSITET

Gjatë vitit akademik 2013- 2014, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane filluan trajnimet e mësuesve në detyrë në kuadër të moduleve të ofruara nga Qendrat e Ekselencës në këto fakultete. *Puna e mirë promovuese e bërë nga stafet e të dy fakulteteve dhe bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore të Rretheve Korçë dhe Pogradec tërhoqi një numër jo të vogël mësuesish që aplikuan për trajnimet në këto qendra. Vlerësojmë veçanërisht përkushtimin e stafit akademik që i realizon trajnimet në kuadër të kontributit të tyre në të mirë të institucionit.*

- Në Qendrën e Ekselencës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë u organizua kualifikimi i mësuesve në tri qendra (Korçë, Pogradec, Devoll) në pesë sesione të ndryshme, duke bërë që të kualifikohen rreth **740 mësues** për të gjitha modulet e kërkuara.

Në fillim të këtij viti akademik pedagogët e Fakultetit aplikuan pranë IZHA-s edhe për *10 module të reja*, duke iu përgjigjur nevojave parësore që ka shpallur Ministria e Arsimit dhe Sportit për kualifikimin e mësuesve në shërbim.

Sivjet u hartua *Udhëzuesi për Kualifikimin Vjetor të Mësuesve*, i cili u dërgua në të gjitha shkollat e rajonit të Korçës. Në muajin nëntor u zhvillua sesioni i parë ku u kualifikuan rreth **210 mësues. Këtë vit do të zhvillohen edhe 5 sesione të tjera në Korçë, Pogradec dhe Devoll.**

- Në Qendrën e Ekselencës së Fakultetit të Shkencave u përgatitën dhe dhe u koduan **24 module** trajnimi në fushat: *Didaktikë Kërkimi Pedagogjik, Didaktikë e Matematikës, Didaktikë e Fizikës, Didaktikë e TIK, Aftësi Drejtimi*, etj. Gjatë vitit 2014 në të u organizuan **17 trajnime në modulet**: Drejtim dhe Administrim i Shkollës, Shkenca Sociale, Filozofi-Sociologji, Shkencat Natyrore: Matematikë, Fizikë, Informatikë. Në përfundim të trajnimeve u çertifikuan **200 mësues në detyrë.**

Nga sa më sipër mund të themi se të dyja Qendrat e Ekselencës janë strukturuar dhe organizuar si njësi bazë të Fakulteteve përkatëse dhe po krijojnë prespektiva shumë të mira zhvillimi të qëndrueshëm në të ardhmen.

2.5 DREJTIME TË PUNËS PËR RRYTJEN E STANDARDEVE AKADEMIKE

Gjatë vitit të ardhshëm është e nevojshme që stafi akademik dhe autoritetet drejtuese t'u kushtojnë vëmendje në vazhdimësi çështjeve të mëposhtme:

- o Zbatimi i rekomandimeve të bëra nga Grupi i Kontrollit të Zbatimit të Ligjshmërisë nritur me Urdhër Nr. 242, dt. 06.06.2014, në bazë të draf- raportit të paraqitur nga ky Grup në lidhje me elementët e mëposhtëm:
 1. Riaplikimi për akreditim apo ristrukturim të programeve të studimit që janë hapur vetëm me VKM e miratimit të kuotave dhe tarifave të studimit në vitet akademike përkatëse.
 2. Rishikimi i pragut të mesatares për studentët që pranohen në ciklin II dhe III të studimeve.
- o Organizimi i **orëve të leksioneve të hapura** u ndërmorr si një nismë për të shkëmbyer përvojën akademike midis brezave të ndryshëm mësimeve në universitet. Ai synoi të rriste ndërgjegjësimin e pedagogëve të rinj për mundësitë që metodologjia e mësimeve ofron në përcjelljen e duhur të informacionit në auditor dhe në përfshirjen aktive të studentëve gjatë orës së mësimit.

Gjatë viti të kaluar akademik u organizua **44 orë** të leksioneve të hapura në të gjitha Fakultetet; ato u organizuan sipas një grafiku të monitoruar nga Zyra e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nga Rektorati. U vu re se pati një impenjim të pedagogëve të rinj për të paraqitur një orë të realizuar leksioni, seminari apo diskutimi, ndërkohë që më pak të tilla u ofruan nga pedagogët me përvojë. *Kjo bëri që natyra e kësaj nisme të kalonte nga një shkëmbim përvojë në orë monitorimi apo kontrolli ku pjesëmarrësi i vetëm i huaj nga jashtë auditorit të ishte përfaqësuesi i Rektoratit apo i NJBSC.*

Orë të tilla do të vazhdojnë të organizohen, ndoshta në një sasi më të vogël dhe më të mirëorganizuar në lidhje me raportin moshë dhe përvojë në mësimdhënie. Ato duhet t'i rikthehen arsyes se përse u ndërmorrën si nismë: *nxitjes së komunikimit midis specialistëve të së njëjtës fushë në lidhje me njohuritë që u përcillen të rinjve në auditor.*

- Formimi praktik i studentëve jashtë Universitetit mbetet ende një problem shqetësues. Për këtë, *do të përmirësohen dhe zgjerohen marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet e rajonit që janë të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e praktikave profesionale të Fakulteteve të Edukimit dhe atij të Shkencave, të Bujqësisë, të Ekonomisë dhe do të rishikohet mundësia e mbështetjes, ndjekjes dhe monitorimit të plotë të këtyre praktikantëve nga pedagogët e stafit akademik. EDE-ja duhet të marrë zgjidhjen përfundimtare për zhvillimin e praktikave, duke u zhdërruar në një qendër në funksion të plotë të praktikave fushore dhe eksperimentimit të Fakultetit. Edhe Fakulteti i Ekonomisë duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një qendre që lidh piksynimet e të nxëniet në programet e studimit dhe zbatimit të tyre në praktikë.*

- *Vënia në funksion të plotë e Qendrës së Karrierës Studentore, Sektori i Informacionit dhe Komunikimit ka të dhëna të plota statistikore të të diplomuarve që kanë mbaruar programet e studimit në Universitetin tonë. Në shumë raste organet drejtuese të universitetit kanë ndjekur një politikë favorizuese për punësimin e studentëve tanë brenda vendit. Megjithatë, kjo Qendër mund dhe duhet të bëjë edhe më shumë në këtë drejtim, duke mbajtur lidhje më të ngushta me institucionet dhe subjektet që ofrojnë vende të reja pune sipas profileve që kanë njësitë e universitetit.*

- ***Vënia në funksion të plotë e sistemit dixhital të sekretarive mësimore.*** Sekretaritetë mësimore do ta përfundojnë hedhjen e të dhënave për të gjithë studentët aktivë të dy viteve të para si dhe unifikimin e formatit të të dhënave dhe informacioneve në ruajtje.

- Sekretaritetë do të përfundojnë punën e nisur për unifikimin e formatit të ruajtjes së të dhënave në formë të shkruar me plotësimin e regjistarve themeltarë të shkruar në formatin e

kërkuar nga MAS me të dhënat përkatëse për secilin student sipas programeve dhe formave të studimit.

- **Rektorati do të vazhdojë monitorimin e aktivitetit mësimor në Universitet.** Njëkohësisht, do të punohet edhe në kuadër të rritjes profesionale të stafit të ri akademik me anë të një grafiku trajnimesh që synojmë të ofrojmë për përmirësimin e metodave të tyre të mësimdhënies, kualifikimit të tyre me mjetet dhe programet e TIK në mësimdhënie, kursit të gjuhës së huaj dhe hartimit dhe shkrimit të të projekteve.

Nga sa u tha më sipër, Universitetit i del për detyrë që gjatë vitit akademik 2014-2015 të çojë më tej aktivitetet e veprimtarisë mësimore të vëna tashmë në zbatim dhe të nxisë ndërgjegjësimin e stafit të tij akademik në lidhje me nevojën që ka rritja e standardeve mësimore në sigurimin e cilësisë së institucionit tonë në këtë drejtim.

3. ANALIZA E VEPRIMTARISË SHKENCORE PËR VITIN AKADEMIK 2014

Veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njërin prej dy shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i Universitetit të Korçës, si një institucion i Arimit të Lartë. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit të tij akademik duke qenë se arrijtjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit të tij në botën e kërkimit shkencor. Ajo është gjithashtu një zë që kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e reputacionit të Universitetit si një qendër kërkimore dhe shkencore në rajon, në komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me zhvillimet akademike në profilet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe në cilësinë e konsulencës që ofron stafi i tij akademik në fushat e zhvillimeve shoqërore, bujqësore, ekonomike, gjuhësore dhe didaktike.

Duke paraqitur një sintezë të aktivitetit të Universitetit në zërat e mësipërm, kjo analizë synon të paraqesë drejtimet në të cilat ky aktivitet ka dhënë kontributin e vet më të qenësishëm gjatë vitit 2014, si dhe të parashtrojë orientimet e mundshme të politikave institucionale për kërkimin, zhvillimin dhe transferimin e njohurive në të ardhmen.

Analiza synon edhe rritjen e mëtejshme të shkallës së ekspertizës dhe vlerësimit të brendshëm të cilësisë së punës kërkimore, si kusht i domosdoshëm për administrimin dhe mirëmenaxhimin e cilësisë për

kualifikimin e vazhdueshëm të personelit përmes kërkimit shkencor, teknologjik dhe inovacionit.

Kjo analizë bazohet në burimet e të dhënave dhe vlerësimeve të bëra në Departamentet dhe Fakultetet e Universitetit, në një shqyrtim statistik, konkret të të dhënave, si dhe të prirjeve që vihen re në përbërësit themelore të veprimtarisë kërkimore.

3.1 AKTIVITETE SHKENCORE TË ORGANIZUARA NGA UNIVERSITETI

Gjatë vitit 2014 *Universiteti “Fan S. Noli” u bë nismëtar i organizimit të disa aktiviteteve shkencore*, të cilat synonin në radhë të parë të promovonin rritjen akademike të stafit të tij, si një element i domosdoshëm në të mirë të mësimdhënies, dhe në radhë të dytë të nxisnin komunikimin me institucionet e arsimit të lartë dhe ato të shoqërisë civile në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Ambientet e tij u bënë strehë e diskutimeve shkencore që ngjallën interesin ndërkombëtar gjatë konferencave, simpoziumeve, lektoriumeve dhe aktiviteteve të mëposhtme të organizuara nga stafet e vetë Fakulteteve:

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1. Përrurim libri | “Arsimi i gjeneratës tjetër” i autorit Pëllumb Karameta. |
| 2. Simpozium shkencor | Kushtuar jetës dhe veprës së Adem Demaçit. |
| 3. Tryezë e rrumbullakët | Me rastin e Javës Globale të Edukimit, Departamenti i Edukimit organizon tryezën e rrumbullakët me temë “Edukimi në arsim, problemet reale dhe praktikat efikase”. |
| 4. Përrurim libri | Për veprën e re të shkrimtarit Teodor Laço “Gropas ‘67”. |
| 5. Tryezë e rrumbullakët | “Mbrotjtja e dialekteve të Gjuhës Shqipe në kushtet e Globalizmit”, bashkëpunim i Ministrisë së Kulturës dhe RIAS. |
| 6. Konferencë shkencore | Në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, Fakultetit i Edukimit dhe Filologjisë organizoi konferencë shkencore kushtuar gjuhëtarit dhe profesorit Dhimtër Samara |
| 7. Bisedë me aktoren Margarita Xhepa | Me studentët e programit “Master Profesional” Gjuhë-letërsi, në kuadër të lëndës minore “Teatër” u bë paraqitja e veprës “Diva shqiptare” të autorit Miho Gjini, për nder të aktores Margarita Xhepa. |
| 8. Përrurim libri | Për paraqitjen e veprës “Trashëgimia shpirtërore e Devollit” e autorit Hysen Koçillari. |
| 9. Konferencë | Me temë: Ndihmesat e studentëve në kërkimin shkencor |

studentore	
10. Simpozium shkencor	Me temë: “Ndhimesat e pedagogëve doktorantë në fushën e edukimit dhe filologjisë”
11. Takim poetik	Me poetin e njohur norvegjez Steinar Opstad dhe poeten shqiptare Olimbi Velaj.
12. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare	“Mendimi kritik në arsim” në bashkëpunim me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore të Follorinës dhe Universitetin “St. kliment Ohridski” të Bitolës.
13. Tryezë e rumbullakët	Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, Departamenti i Edukimit organizoi veprimtarinë: “Më pranë fëmijëve në ditën ndërkombëtare të të drejtave të tyre”.
14. Sesion shkencor	Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë, në bashkëpunim me studentët, organizoi sesion shkencor kushtuar 70-vjetorit të Çlirimit
15. Veprimtari studentore	Këshilli studentor i fakultetit, hapi ekspozitën me krijimet e studentëve piktorë: Dajana Shkëmbi, Taulant Zaçlli, Thanas Dushku.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane:

Simpoziume Shkencore	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>”Jeta dhe vepra e Sterjo Spasse-s”</i> në kuadrin e 100-vjetorit të lindjes, 30.05.2014. 2. <i>”Aretologjia, filozofia e virtutit ne antikitetin grek”</i> në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Filozofisë.5.12.2014.
Lektoriume dhe aktivitete te ngjashme	<ol style="list-style-type: none"> 3. “Arti alternativ dhe ndikimi i influencave shumëdimensionale”; Piktori i merituar Anastas Konstandini. Lektorium dhe Ekspozitë Figurative me temë <i>“Pasqyra e thyer”</i>. 28.03.2014 4. <i>“10-vjetori i Polonisë në BE”</i>. Lektorium i Ambasadorit të Polonisë në Shqipëri, 20.05.2014 5. Akademi për Europën. Në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Ndërkombëtare; 7.11.2014 6. Lektorium për avokatinë; 4.12.2014

Fakulteti i Bujqësisë:

1. Seminar	24 Nëntor 2014 “MBROJTJA E TOKES, GARANCI PER GJENERATAT E ARDHESHME” Departamenti i Agronomisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Shkencës së Tokës dhe qendrën e studimeve të burimeve natyrore, në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Dheut të 5 dhjetorit.
-------------------	--

Fakulteti i Ekonomisë:

1. Simpozium shkencor

PhD Symposium 2014; Organizuar për promovimin e kontributit kërkimor të doktorantëve të këtij Fakultetit në 24 Shkurt 2014

Përvoja e krijuar tashmë në disa Fakultete me aktivitete shkencore që synojnë të sjellin nga viti në vit të rehat e kërkimit shkencor dhe t'i promovojnë ato në tryeza diskutimi kombëtar dhe ndërkombëtar duhet të kthehet në një traditë dhe duhet të përqaset si një domosdoshmëri që ndihmon kominikimin shkencor mes vete fakulteteve dhe insitucioneve të tjera simotra. *Në këtë kuadër, dy vlerat e veprimtarive të mësipërme: ajo sasiore dhe ajo cilësore duhet të bashkërendohen dhe të mirëbalancohen në planifikimet që Fakultetet kanë për vitin aktual. Të gjithë departamentet duhet të angazhohen në organizimin e veprimtarive shkencore të kuadrit rajonal dhe bashkëpunimin e tyre ta realizojnë në veprimtari të një kuadri më të gjerë me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë mënyrë, të gjithë fakultetet do të mund të japin një kontribut më të barasvlefshëm në kurrikulën kërkimore të Universitetit.*

Një zë që është për t'u vlerësuar në kadrin e kërkimit shkencor mbetet *pjesëmarrja e gjerë e pedagogëve të universitetit në konferenca shkencore të organizuara nga universitetet simotra brenda dhe jashtë vendit*, ndër të cilat mund të përmendim:

Fakulteti	Pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ ndërkombëtare 2013	Pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ ndërkombëtare 2014
Fakulteti i Ekonomisë	64	34
Fakulteti i Shkencave	87	43
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	123	97
Fakulteti i Bujqësisë	28	24
Gjithsej	302	198

Megjithëse shifrat mësipër tregojnë një rënie të aktivizimit të stafit në nivel universitar, në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, *secili fakultet duhet të reflektojë mbi arsyet përkatëse të kësaj rënieje*. Ajo që duhet pasur parasysh është se pjesëmarrja në aktivitete të kërkimit shkencor nuk bëhet vetëm dhe për hir të pasurimit të dosjes individuale të një pedagogu për aplikimin e marrjes së titujve shkencorë dhe në momentin e miratimit të tij, pedagogu zgjedh të reduktojë kërkimin e tij shkencor. *Pjesëmarrja në konferenca, simpoziume, kongrese shkencore ndërkombëtare duhet parë si një element nëpërmjet të cilit secili pedagog, së pari, promovon kërkimin e tij shkencor në fushën përkatëse, duke përsjellë kështu vlerët e këtij kërkimi në emër të*

universitetit; dhe së dyti, sjell në Universitet përvojën ndërkombëtare të përftuar nga diskutimi shkencor në aktivitet, për të cilën ne vazhdojmë ende të jemi të etur për vetë kushtet e kërkimit shkencor në vend dhe aplikimit të tij në drejtimit e mësimdhënies që ofrojmë.

3.2 VEPRIMTARIA SHKENCORE BOTUESE

Veprimtaria shkencore botuese e Universitetit pasqyron një angazhim të plotë të stafit të të gjithë departamenteve. Për faktin që botimet paraqesin shumëllojshmëri në llojin e buletineve të botuar (sidomos ato ndërkombëtare) dhe në tipet e teksteve të botuara nga vetë pedagogët, mund të themi se **ky zë i veprimtarisë kërkimore - shkencore po përmbush kriteret e cilësisë së institucionit si një qendër kërkimore që vë në dispozicion të lexuesve të interesuar në fusha të ndryshme të kërkimit, literaturë tashmë të maturuar.**

Artikuj të botuar në buletine

Universiteti “Fan S. Noli” nxjerr periodikisht Buletinin e tij të botuar në dy seri përkatësisht të shkencave shoqërore dhe atë të shkencave të zbatuara. Në botimin e këtij viti u përfshinë punimet e **73** autorëve, respektivisht **28** autorë nga shkencat shoqërore dhe **23** nga ato ekzakte.

- *Buletini i Shkencave Shoqërore* - 23 artikuj, prej të cilëve 14 janë artikuj të stafit akademik të vetë Universitetit;

- *Buletini i Shkencave Ekzakte* - 20 artikuj, prej të cilëve 10 janë artikuj me autorë ose bashkëautorë pedagogë të Universitetit tonë.

Krahasuar me botimin e një viti më parë ka një rënie prej 15 artikujsh, kryesisht në serinë e shkencave ekzakte, megjithatë sasia nuk është domosdoshmërisht një tregues arritjesh. Qëllimi parësor për të cilin ky Buletin botohet është promovimi i kërkimit shkencor të stafit akademik dhe vënia në dispozicion të kolegëve dhe studentëve të materialeve që i ndihmojnë ata në fushat respektive të të nxënies. *Megjithatë ky buletin shërben edhe si një element që i përçon kërkimin e zhvilluar në Universitet përtej rajonit dhe si i tillë duhet të përcjellë vlera konkrete të aplikimit të kërkimit në shoqëri.*

Në këtë kuadër është shumë e domosdoshme që Sektori i Kërkimit dhe Projekteve të intensifikojë punën për *regjistrimin online* të këtij buletini. Reformimi i aktivitetit kërkimor dhe shkencor në IAL-të shqiptare pritet të krijojë hapësirat e duhura financiare që i nevojiten

një angazhimi të tillë: *botimi në gjuhë të huaj, kalimi në një proces të dyfishtë recensimi, përmirësimi i cilësisë së redaktimit dhe aplikimin e programeve kompjuterike të ruajtjes së të drejtave të autorit. Gjithësesi, në pritje të këtyre ndryshimeve ligjore, Sektori duhet të paraprijë me projekte konkrete, zbatueshmërinë e ideteve që kanë lindur deri më sot në lidhje me botimin e tij. Një promovim më i madh i këtij Buletini në universitetet dhe institucionet me të cilat ne bashkëpunojmë deri më sot, do të ndihmonte në rritjen e cilësisë së artikujve që përfshihen në të.*

- ***Tekste, dispenca dhe monografi***

Ky zë i kërkimit shkencor është gjithashtu për t'u vlerësuar. Siç do të përmendim edhe më poshtë viti 2014 ishte vit në të cilin mjaft pedagogë u kualifikuan duke marrë tituj dhe grada shkencore. Si pjesë e punës së tyre për të plotësuar kriteret e aplikimit për rritjen e tyre akademike, por edhe për t'i ardhur në ndihmë studentëve gjatë procesit mësimor, disa prej tyre botuan tekste, dispenca dhe monografi sipas fushave të tyre të studimit.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se në Universitet u botuan:

- ***5 tekste universitare dhe 10 dispenca*** që i përkasin *fushave të mikro dhe makroekonomisë, menaxhimit, sistemit tatimor, drejtimit financiar dhe sistemit tatimor, turizmit, etj*, të ofruara në programet e studimit të Fakultetit të Ekonomisë;
- ***3 tekste*** të *studimeve matematikore dhe infermieristike, 3 botime* të *Departamentit të Shkencave Sociale dhe 1 monografi*, të botuara nga stafi i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Humane
- ***2 tekste*** *mësimore për studentët, 1 dispencë, 3 përmbledhje të punimeve të konferencave*, nga të cilat *seria e parë e Vjetarit Shkencor "FEF"* do të vazhdojë të botohet në vijim si promovim i aktiviteti akademik të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

3.3 KUALIFIKIMI SHKENCOR

Kualifikimi shkencor mbetet treguesi më i rëndësishëm i aktivitetit kërkimor-shkencor, sepse ai kurorëzon gjithë veprimtarinë kërkimore dhe mbështet procesin mësimor të stafit akademik. Me kënaqësi mund të themi se viti 2014 shënoi një hop të madh cilësor dhe sasior në këtë drejtim. ***Të gjithë Fakultetet promovuan marrjen e titujve akademikë dhe gradave shkencore*** dhe stafi i ri vazhdon të jetë në proces të mbylljes së studimeve doktorale. ***Komisionet e rekrutimit të stafit akademik u kujdesën që***

kandidatët që u shpallën fitues të kishin të paktën kualifikimet e gradës Master Shkencor dhe të ishin regjistruar në Shkolla Doktorale.

Me rekrutimet dhe kualifikimet e mëtejshme të stafit akademik këto të dhëna u përmirësuan. Në rang universiteti u kualifikuan: **6 Profesorë të Asociuar** (2 në F. e Ekonomisë/ 4 në F. e Bujqësisë), **10 Doktorë Shkencash** (6 në F. e Edukimit dhe Filologjisë/ 2 në F. e Ekonomisë/ 1 në F. e Bujqësisë/ 1 në F. e Shkencave). U zvogëlua ndjeshëm numri i Asistent Pedagogëve në favor të rritjes së numrit të Doktorëve të Shkencave dhe të kualifikuarve në programet Master i Shkencave. Në përfundim të vitit 2014 pasqyra e kualifikimit për stafin akademik të Universitetit paraqitet si më poshtë:

Tituj dhe grada shkencore	Fakulteti i Edukimit	Fakulteti i Shkencave	Fakulteti i Ekonomisë	Fakulteti i Bujqësisë	Gjithsej
1 Prof.dr.	1	1	2	1	5
2 Prof.as.dr.	6	2	14	9	31
3 Docent	4	2	1	-	7
4 Doktor	11	5	4	7	27
5 Msc.	25	31	8	4	68
6 As.Ped.	2	5	4	1	12
TOTAL	49	46	33	22	150

Ritmet e përmirësimit të këtyre raporteve parashikohen të jenë po kaq intensive edhe gjatë vitit të arshëm, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e pedagogëve që janë në process doktore parashikojnë mbrojtjen e saj brenda dhjetorit 2015 dhe të tjerë janë në përfundim të plotësimit të dosjeve të aplikimit për marrjen e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor Doktor”.

Udhëheqje doktore

7 prej titullarëve të universitetit janë angazhuar në udhëheqjen e punimeve të doktoraturës për 15 doktorantë, që po ndjekin studimet doktorale pranë Universitetit tonë dhe atij të Tiranës.

3.4 PJESËMARRJA NË PROJEKTE NË KUADËR TË ZGJERIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIM-ZHVILLIMIT

Universitetit është tashmë i përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim – zhvillimit. Megjithatë vihet re që pjesëmarrja e pedagogëve në to vazhdon të jetë e kufizuar në fushat e kërkimit bujqësor, shëndetit publik dhe pak në fushat e zhvillimit ekonomik dhe shkencat natyrore dhe ato të edukimit.

Projektet në të cilat është angazhuar tashmë një pjesë e stafit të universitetit janë si më poshtë:

Projekte të fituara nga Komisioni Evropian

	Titulli i projektit	Drejtuesi	Kombëtar/Ndër kombëtar	Ekipi kërkimor
1.	ELISAA	Gjergji Mero	Ndërkombëtar	Gjergji Mero, Ilir Nicko, Irena Kallco, Ardian Cerava, Fatos Zerelli
2.	LifeADA	Gjergji Mero	Ndërkombëtar	Gjergji Mero, Ilir Nicko, Irena Kallco, Ardian Cerava, Fatos Zerelli
3.	Tempus	JP 158777 - 2009	University of Reading UK	Western Balkan Rural Extension Network through Curriculum Reform
4.	TEMPUS	544169-TEMPUS-1-2013-1-BE-TEMPUS-JPCR	University of Brussel	Competency Based Curriculum Reform in Nursing and Caring in Western Balkan Universities
5.	TEMPUS	544595-TEMPUS-1-2013-1-HR-TEMPUS-JPHES	University of Zagreb	Lifelong learning for sustainable agriculture in Alps- Danube- Adriatic Region
6.	TEMPUS	544302-TEMPUS-1-2013-1-DE-TEMPUS-SMGR	Univeristy of Koblenz-Landau, Germany	Enhancing albanian system of quality assurance in higher education: application of the process- and outcome-based methodology
7.	IPA CBC Albania-Greece	2012/287-833	University of Ioannina	Developing Information Technology based Nursing Education Network
8.	ERASMUS	BASILEUS	Gent University	Scholarships for academic exchange between EU and Western Balkans
9.	Tempus	158875-TEMPUS-IT-TEMPUS-JPCR	University of Bari (Italy)	International Joint Master Degree in Plant Medicine (IPM)
10.	Tempus	517117-Tempus-IR-2011	Limerick Institute of Technology, Ireland	Developing information literacy for lifelong learning and knowledge economy in Western Balkan countries.
11.	Tempus	530531-Tempus – IT-2012	University of Bari (Italy)	Electronic learning innovations in Sustainable Albanian Agriculture

Pjesëmarrje në veprimtari të organizuara në kuadër të projekteve

- Departamenti i Edukimit FEF është partner me Universitetin e Padovës në një projekt në kuadër të “Horizon 2015”.
- **“Arsimi gjithpërfshirës”** me ko-ordinator Universitetin e Bolonjës dhe me partnerë Univeristetin “Aleksandër Xhuvani”, SAVE THE CHILDREN dhe MEDPAK.
- Kontributi shkencor i Fakultetit Ekonomik dhe rritja e aksesit të “produktit final” në tregun e punës”
- Pjesëmarrje në Projektin TEMPUS ELIZA Trajnim me teme “Prodhimi i energjise me biomase” Shtator 2013 Universiteti Aldo Moro, Itali.
- Pjesëmarrje në projektin E-learning Innovation in Suastainable Albanian Agriculture” Shkurt 2013, Bari Itali,
- Pjesëmarrje në projektin E-learning Innovation in Suastainable Albanian Agriculture” 20-25 shtator 2013, Bari Italy.
- Marrja pjesë në projektin Tempus-m mbi ekstensionin “RURAL EKSTENSION NETWORK” NOVISAD SERBIA.
- EUREQA- dhe ENCHASE kanë realizuar mjaft hskëmbime përvojash në universitetet evropiane partnere për sigurimin dhe rritjen e cilësisë së brendshme në Univeristet.

Gjatë këtij viti akademik Universiteti do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere në kuadër të projekteve të sipërpërmendura.

Ajo që vihet re dhe që shfaqet si një problematikë e viteve në vazhdim është se ***fusha e kërkim-zhvillimit dhe aplikimit në projekte ka vend për përmirësime të mëtejshme***. Duke qenë se nevojat për zhvillim në institucionin tonë dhe idetë që lindin prej tyre nuk mungojnë, vështirësia qëndron në faktin që pedagogët nuk janë të përfshirë mjaftueshëm në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2014 Universiteti mirëpriti organizmin e dy takimeve promovuese për hapjen e thirrjeve për projekte në kuadrin e aplikimeve në Erasmus + dhe Green-Tech 2014-2018. Megjithatë vazhdon të jetë një domosdoshmëri fakti që *Zyra e Kërkimit dhe e Projekteve si dhe ajo e Marrëdhënieve me Jashtë të forcojnë bashkëpunimin e tyre në lidhje me rritjen e komunikimit mes stafit të interesuar në fakultetet e universitetit tonë dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë partneritet në projekt-propozime, si dhe organizimi i trajnimeve të vazhdueshme me stafin akademik për mënyrën se si mund të aplikohet në një projekt si institucion partner, si mund të hartohet drafti i një projekti dhe si të përfshihen grupe të ndryshme interesi në të.*

- *Zyrat duhet të venë vazhdimisht në dispozicion të të interesuarve edhe informacion në lidhje me organizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë që ofrojnë bashkëpunim në kuadër të projekteve të përbashkëta.* Ky

informacion duhet në çdo rast t'i paraprijë mjaftueshëm në kohë afatit të përfundimit të aplikimit.

3.5 DREJTIME TË PUNËS PËR RRRITJEN E AKTIVITETIT KËRKIMOR-SHKENCOR

Gjatë vitit të ardhshëm, ashtu siç edhe u përmend më sipër, pritet që Reforma e Aktivitetit Kërkimor - Shkencor do të sjellë ndryshime të genësishme në strukturat universitare që do të profilizohen në këtë drejtim. Vetë natyra e punës së këtyre punonjësve do të rigjenerojë ide në lidhje me çështje të prekshme të kërkimit shkencor. *Shpresojmë që kjo të shoqërohet e dhe me kritere që do të lehtësojnë matjen e aktivitetit shkencor sipas standardeve të njëjta në nivel akademik, që do të standardizojnë kriteret e aktiviteteve shkencore të mirafillta dhe do të krijojnë një rrjet kombëtar të koordinimit dhe mbështetjes së projekteve.*

Ndërkohë është e nevojshme që stafi akademik dhe autoritetet drejtuese të Universitetit t'u kushtojnë vëmendje në vazhdimësi çështjeve të mëposhtme:

1. ***Thellimi i mëtejshëm i punës organizative të departamenteve mbi bazën e kërkesave të natyrës së aktivitetit kërkimor të secilit.*** Në këtë kuadër stafi që merret me aktivitet kërkimor dhe shkencor duhet të nxitet ta promovojë atë brenda njësisë në të cilin ai bën pjesë. *Përvoja e paraqitjes së vazhdueshme të informacioneve shkencore* duhet të rikthehet në Departamente apo Fakultete si një provë e diskutimit shkencor. Debati shkencor mund edhe të zgjerohet më tej *me pjesëmarrjen në diskutime mediatike* apo me organizimin e tryezave të rumbullakta ku ftohhen përfaqësues të institucioneve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e programeve të studimit.

2. ***Krijimi i strukturave kërkimore brenda Fakulteteve që të do të jenë në vazhdimësi në kërkim të aplikimeve për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të realizojë bashkërendimin e punës së departamenteve në këtë drejtim.*** Kjo strukturë do të merret edhe me *organizimin e veprimtarive shkencore në Fakultet* dhe do të nxisë vazhdimisht *promovimin e punës shkencore dhe kërkimore nga njëri departament te tjetri dhe më gjerë.* Synimi është që në vitet në vazhdim këto grupe të formojnë një rrjet bashkëpunimi me Zyrën e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.

3. ***Thellimi i mëtejshëm i punës kërkimore me studentët nëpërmjet komunikimit të rezultateve të kërkimit në fakultete dhe trajnimi i tyre me konceptet dhe parimet bazë të etikës në kërkim.*** Studentët e viteve të fundit të ciklit të parë dhe ata të nivelit Master duhet të vazhdojnë të nxiten *të marrin pjesë në aktivitetet shkencore që organizon universiteti dhe të mund të*

përdorin si burime reference artikujt e botuar edhe brenda vendit apo brenda universitetit. Në tezat e tyre të diplomës është mire të trajtohen problematika dhe këndvështrime aktuale që lidhen edhe me projekte të përbashkëta me pedagogët e programeve të tyre të studimit me qëllim që punimet përfundimtare të fitojnë maturinë e shprehjes së mendimit shkencor dhe të vlejnjë edhe për të ardhmen e Universitetit në fushat e interesit.

4. ***Përkrahja dhe mbështetja financiare e stafit akademik që ndërmerr botimin e dispencave, teksteve apo materialeve që synojnë të lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të rrisin komunikimin akademik mes pedagogëve, kolegëve të tyre dhe studentëve.***

Së fundmi stafi kërkimor shkencor i Universitetit angazhohet që përveç realizimit të planifikimeve individuale që lidhen me kualifikimet shkencore, të bashkëpunojë në organizimin e veprimtarive shkencore që synojnë të nxisin diskutimin akademik në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

SHTOJCA 1

1. a. PROGRAME BACHELOR ME KOHË TË PLOTË VITI AKADEMIK 2013-2014:

<i>Nr.</i>	<i>FAKULTETI</i>	<i>PROGRAMI I STUDIMIT</i>	<i>SISTEMI</i>
1.	Fakulteti i Bujqësisë	Agroushqim	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
2.		Agrobiznes	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
3.		Teknologji e Prodhimit Bimor	Kohë e plotë
4.		Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
5.	Fakulteti i Ekonomisë	Financë - Kontabilitet	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
6.		Menaxhim	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
7.		Marketing/Administrim Biznesi në Marketing	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
8.		Turizëm/ Administrim Biznesi në Turizëm	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
9.		Administrim Biznesi në Turizëm (Pogradec)	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
10.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Gjuhë –Letërsi	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
11.		Gjuhë- Letërsi Shqipe dhe Frënge	Kohë e plotë
12.		Gjuhë Angleze	Kohë e plotë
13.		Mësuesi për Arsimin Fillor klasa I- VI	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
14.		Mësuesi për Arsimin Parashkollor/Cikël i Ulët parashkollor	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
15.		Histori –Gjeografi	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
16.		Mësuesi për Arsimin Fillor klasa I- VI (Pogradec)	Kohë e plotë
17.		Cikël i Ulët –Anglisht (Pogradec)	Kohë e plotë
18.	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane	Filozofi -Sociologji	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
19.		Matematikë -Fizikë	Kohë e plotë
20.		Matematikë -Informatikë	Kohë e plotë
21.		Biologji -Kimi	Kohë e plotë
22.		Teknologji informacioni	Kohë e plotë
23.		Infermieri e Përgjithshme	Kohë e plotë/Kohë e pjesshme
24.		Mami	Kohë e plotë
25.		Administrim dhe Politika Sociale	Kohë e plotë

2. PROGRAME MASTER I SHKENCAVE:

	<i>FAKULTETI</i>	<i>PROGRAMI I STUDIMIT</i>
1.	Fakulteti i Bujqësisë	Mjekësi e Bimëve
2.	Fakulteti i Ekonomisë	Financë
3.		Administrim Biznesi në Turizëm dhe Mikpritje
4.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI
5.	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	Filozofi Sociale

3. a. PROGRAME MASTER PROFESIONAL:

<i>Nr.</i>	<i>FAKULTETI</i>	<i>PROGRAMI I STUDIMIT</i>	<i>SISTEMI</i>
1.	Fakulteti i Bujqësisë	Zhvillim i Integruar Rural	Kohë e plotë
2.	Fakulteti i Ekonomisë	Financë - Kontabilitet	Kohë e plotë
3.		Administrim Biznesi	Kohë e plotë
4.		Marketing	Kohë e plotë
5.		Turizëm	Kohë e plotë
6.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në “Gjuhë –Letërsi”, me profil minor “Arte”	Kohë e plotë
7.		Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë në “Gjuhë Angleze”, me profil minor “Arte”	Kohë e plotë
8.		Mësuesi në “Histori –Gjeografi”	Kohë e plotë
9.		Mësuesi për “Cikël të Ulët”	Kohë e pjesshme
10.		“Mësimdhënie”	Kohë e pjesshme
11.	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	Mësuesi, për Arsimin e Mesëm në “Shkenca Sociale” me Profil Minor “Edukim Qytetar”	Kohë e plotë
12.		Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në “Matematikë –Fizikë” me Profil Minor “Informatikë”	Kohë e plotë
13.		Mësuesi për Biologji-Kimi	Kohë e plotë
14.		Teknologji Informacioni	Kohë e plotë
15.		Infermieristikë	Kohë e plotë

4. PROGRAME TË DOKTORATËS

<i>Nr.</i>	<i>FAKULTETI</i>	<i>PROGRAMI I STUDIMIT</i>
1.	Fakulteti i Bujqësisë	Hortikulturë e Qëndrueshme